



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 45

Prishtinë, më 24.1. 2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, kryetar, Ganimete Musliu, nënkryetare e parë,
Rexhep Selimi, Anton Quni, Fatmir Shurdhaj, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha, anëtarë.

Munguan: Bojan Mitiq dhe Qerim Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati-Zyra e Presidentit të Kosovës; Blend Zyrapi
dhe Gent Gjokolli-KIPRED; Dhurata Kryeziu-OSBE dhe Genc Jaha-KDI.

Nga Stafii mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më datë 29.11.2016; 7.12.2016 dhe 20.12.2016;
3. Miratimi i raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2016;
4. Miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2017;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 04/L-214;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, propozoi që të shtohet, si pikë e pestë e rendit të ditës, edhe shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime: pikë e gjashtë e rendit të ditës u shtua shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më datë 29.11.2016; 07.12.2016 dhe 20.12.2016

Procesverbalet e datës 7.12.2016 dhe 20.12.2016, u miratuan pa vërejte, ndërsa procesverbali i datës 29.11.2016, u miratua me vërejtje.

3. Miratimi i raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2016

Nuredin Ibishi, theksoi se do të ishte mirë që edhe raporti i Autoritetit Civil të Aviacionit, të shqyrtohet si dhe të raportohet nga ana e këtij autoriteti, në aspektin e sigurisë.

Kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, pas diskutimeve, konstatoi miratimin e raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2016.

4. Miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2017

Kryetari, theksoi se draft-plani i propozuar, është bazuar në strategjinë legislative të Qeverisë, ndërkohë plani i punës për vitin 2017, mund të plotësohet edhe me aktivitete të tjera.

Rexhep Selimi, kërkoi sqarim lidhur me aktivitetin e paraparë për mbikëqyrjen e Ligjit për përgjimin e telekomunikimeve, marrë në konsideratë se në fazën kur është shqyrtuar, është ngarkuar Komisioni për Integritet Evropian. Pra, për këtë çështje duhet të bëhet një definim, se cili komision duhet të mbikëqyrë këtë fushë. Më tutje, theksoi se Projektligji për plotësimin dhe

ndryshimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura, i cili është planifikuar në muajin nëntor, konsidero se është planifikim i vonë, pasi është fundi i vitit dhe kërkoi që ky projektligj, mundësisht, të jetë në fillim të vitit.

Zafir Berisha, lidhur me Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin, që ka të bëjnë me Forcën e Sigurisë së Kosovës, theksoi se ky projektligj duhet të jetë në fillim të vitit, në janar ose në fillim të muajit shkurt, pasi ka konsensus dhe nuk duhet të shtyhet.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, konstatoi miratimin e planit të punës së Komisionit për vitin 2017, me plotësimet e propozuara.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 04/L-214

Kryetari, propozoi që projektligji të miratohet në parim, në seancë plenare. Nëse nuk ka vërejtje, e procedojmë.

Në këtë pikë të rendit të ditës, *Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, nxori këtë:*

REKOMANDIM

Projektligjit nr.05/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-214, vlerësoi se Projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit, për t'u proceduar për shqyrtim të parë në mbledhje plenare dhe i rekomandon Kuvendit, miratimin e tij në parim.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive

Kryetari, propozoi që të formohet grupi punues për shqyrtimin e projektligjit. Propozoi për kryesues, z. Rexhep Selimi, z. Nuredin Ibishi dhe z. Fatmir Shurdhaj, anëtarë. Më tutje, vlerësoi rëndësinë e këtij projektligji, i cili duhet të miratohet.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyre të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë:

VENDIM

Formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive, me këtë përbërje: Rexhep Selimi, kryesues, Nuredin Ibishi, Fatmir Shurdhaj, anëtarë.

7. Të ndryshme

Kryetari, njoftoi se më datë 23 janar është takuar me nënkryetarin e Komisionit të Mbrojtjes të Parlamentit të Italisë, ku nga ana e tij është shprehur nevoja për një transformim të FSK-së, në Forca të Armatosura, themelimi i bazës ligjore për ndalimin e pjesëmarrjes në konflikte jashtë vendit, si dhe është theksuar çështja e liberalizimit, duke shtuar se si vend, jemi të izoluar në këtë aspekt, pavarësisht plotësimit të kriterëve. Gjithashtu, njoftoi për takimin me gratë në sektorin e sigurisë (Policia e Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme), aktivitet i iniciuar nga znj. Ganimete Musliu.

Qëllim i këtij takimi ishte ofrimi i mbështetjes nga ana e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Ganimete Musliu, njoftoi për takimi me përfaqësueset gra të sektorit të sigurisë, me Shoqatën e Grave Police, përfaqësueset nga Ministria e FSK-së dhe FSK-ja, përfaqësueset nga organizatat ndërkombëtare, UNWOMEN, DCAF dhe OSBE, ku pjesëmarrës në këtë takim ishte edhe kryetari i Komisionit, z. Daut Haradinaj dhe z. Nuredin Ibishi.

Më tutje, theksoi se qëllimi i këtij takimi ka qenë që përmes veprimeve të përbashkëta, të përkrahët dhe fuqizohet roli i gruas në sektorin e sigurisë, njohja me sfidat që hasin gjatë punës, ku është vendosur që të mbahen takime të rregullta mujore dhe se çështja e avancimit të gruas në uniformë të jetë në agjendë të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së. Nga ana e tyre, janë shprehur shqetësimet, siç kanë qenë tendenca e lënies së punës e grave me uniformë nga radhët e Policisë së Kosovës, pushimi i lehonisë, sigurimet shëndetësore, shqetësimi për mundësinë e uljes së pagave etj. Në përfundim të fjalës së saj, konsideroi që, si zëvendëskryetare e Komisionit, do të lehtësojë komunikimin dhe adresimin e çështjeve dhe sfidave të grave në uniformë, duke kërkuar mbështetjen e Komisionit, për këtë çështje.

Kryetari, fillimisht shprehu shqetësimin për mundësinë e uljes së pagave të njësisë elite të Policisë së Kosovës, duke shtuar se për këtë çështje, do të duhej të ftohet në takim ministri i Punëve të Brendshme, si dhe sekretari i Ministrisë, për të parë sesi e kanë planifikuar nivelimin e pagave. Gjithashtu, njoftoi anëtarët e Komisionit, që përderisa nuk mund të bëhen ndryshimet kushtetuese, sa i përket çështjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës, ka marrë të gjitha materialet, ligjet, si dhe draft-planin për transformimin FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, duke theksuar se ka propozuar ndryshimin e Ligjit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, ndryshim i cili do të ndryshonte misionin e FSK-së, pasi që edhe për një kohë, duket se çështja e transformimit do të mbetet peng e “Listës Serbe”, duke e vlerësuar të nevojshëm që, si deputetë dhe anëtarë të Komisionit, të bëjnë ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në mënyrë që t’i jepen kapacitete të plota dhe kjo të bëhet në koordinim me Qeverinë e Kosovës, NATO-n dhe KFOR-in, duke kërkuar nga anëtarët e Komisionit, që këtë çështje ta diskutojnë edhe me shefat e grupeve parlamentare, me qëllim që të dilet me një qëndrim të përbashkët.

Më tutje, theksoi se posedon të gjitha dokumentet, ligjet, propozim-amendamentet, të cilat parashikojnë ndryshimin e misionit të FSK-së, në Forca të Armatosura të Kosovës. Po ashtu, ftoi

anëtarët e Komisionit në diskutim, ndërkohë në takim do të jetë edhe ministri i FSK-së dhe komandanti i FSK-së.

Rexhep Selimi, theksoi se përderisa nuk mund të bëhen ndryshimet kushtetuese për ndryshimin e emrit dhe misionit të FSK-së, për shkak të pengesave që krijohen nga një grup parlamentar (Lista Serbe), ndryshimi i misionit mund të bëhet përmes ndryshimit të ligjit, duke i ndërruar misionin FSK-së, por jo ndryshim nominal. Ndryshimi i misionit është esencial dhe shtoi se çdo ndryshim, i cili garanton rritjen e kapaciteteve, konsideroi që duhet të ndodhë, duke shtuar se edhe me strukturën ligjore aktuale, FSK-ja ka mundur të mbështetet edhe më shumë, pasi nuk ka ndalesa që të ketë më shumë buxhet, më shumë pajisje, më shumë ushtarë dhe më shumë armatim, janë elemente që nuk ndalohen as nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Ndërsa, sa i përket çështjes së pagave të Policisë së Kosovës, theksoi se me këtë çështje është njoftuar edhe Qeveria e Kosovës, që njësitë e intervenimit, speciale dhe profesionale, të mos kenë ulje të pagave, por të kenë rritje, qoftë edhe të shtesave, për shkak të natyrës së punës së tyre. Gjithashtu, konsideroi që kërkesa për krijimin e Njësisë së Helikopterëve, në kuadër të Policisë së Kosovës, është bërë me vonesë, pas miratimit të buxhetit për vitin 2017, edhe pse kjo gjë mund të bëhet gjatë rishikimit të buxhetit. Sa i përket çështjes së pagave, konsideroi që duket një divergjencë në qëndrime nga ana e Qeverisë, dhe si Komision, duhet të mbështesin këtë çështje, pasi duket se ka një mungesë vullneti nga protagonistët kryesorë.

Anton Quni, lidhur me çështjen e transformimit të FSK-së, në Forca të Armatosura të Kosovës, theksoi se sa përket alternativës që kjo çështje të bëhet përmes ndryshimit të Ligjit të FSK-së, konsideroi që duhet parë pengesat, duke e vlerësuar të nevojshëm bashkëpunimin me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Po ashtu, theksoi se është mirë që ky proces të mos shndërrohet në një garë, se kush i merr meritat për rezultatin pozitiv, duke vlerësuar që ky proces duhet të fillojë dhe të përfundojë me sukses, në mënyrë që në fund, t'i përshëndesim në parakalim, Forcat e Armatosura të Kosovës.

Zafir Berisha, vlerësoi konsensusin që është në mes të Komisionit dhe partive politike, sa i përket çështjes së transformimit të FSK-së, në Forca të Armatosura, ndërsa e mbështeti iniciativën për ndryshimin ligjeve të FSK-së, për të ndryshuar misionin e saj, ide të cilën e kishte hedhur edhe në takime të tjera. Gjithashtu, propozoi që pasi të jetë në Komision, ministri i FSK-së dhe komandanti i FSK-së, takimi të jetë me dyer të mbyllura. Më tutje, konsideroi që është e nevojshme ndërmarrja e kësaj iniciative dhe të ndryshohet misioni i FSK-së, duke mos u ngushtuar në qëndrime se kush nga partitë e inicioi, pasi kjo është çështje e interesit të përbashkët.

Fatmir Shurdhaj, fillimisht ngriti çështjen e pagave për Policinë e Kosovës, për të cilën është diskutuar mundësia e uljes dhe vlerësoi që për njësitë kufitare dhe njësitë e specializuara, si dhe për policinë, në përgjithësi, të bëhet rritja e pagave dhe krijimi i kushteve më të mira të punës, pasi ulja e pagave është e papranueshme.

Ndërsa, sa i përket FSK-së, konsideroi që, edhe pse kjo çështje është diskutuar që nga viti 2014, ku sukseset e saj kanë qenë evidente me kuadro dhe në performacë, është Kushtetuta e Kosovës që e sanksionon këtë çështje, duke i dhënë të drejtën minoriteteve (komunitetit serb), që bazuar edhe në Planin e Ahtisaarit, vendos edhe për shndërrimin e FSK-së, në Forca të Armatosura të Kosovës. E konsideroi pozitive gjetjen e një modifikimi për përshtatjen dhe ndërrimin e misionit

të FSK-së, dhe ndryshimet e ligjit, të jenë deri në momentin që ndryshohet Kushtetuta, ku në të ardhmen, edhe në Kushtetutë, të jenë si Forca të Armatosura të Kosovës dhe kjo çështje të jetë në koordinim me faktorin ndërkombëtar dhe Aleancën Veri-Atlantike.

Nuredin Ibishi, theksoi se sa i përket çështjes së transformimit të FSK-së, në Forca të Armatosura të Kosovës, përmes ndryshimit të Ligjit, është një zgjidhje e duhur, për shkak të rrethanave të krijuara dhe kjo çështje duhet të bëhet në koordinim me prezencën ndërkombëtare, civile dhe ushtarake. Ndërsa, sa i përket çështjes së pagave të Policisë së Kosovës, që mund të preken nga Ligji për nivelimin e pagave, theksoi që kjo çështje do të jetë pak e vështirë, dhe si Komision, duhet të ofrojmë mbështetjen për këtë çështje, në mënyrë që strukturat e sigurisë, të jenë të sistemuara mirë, përfshirë edhe rrezikshmërinë në punë.

Kryetari, vlerësoi se pasi tashmë në takim janë ministri i FSK-së, z. Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në koordinim me anëtarët e Komisionit, konstatoi që takimi në vazhdim, do të mbahet me dyer të mbyllura, ndërsa pas përfundimit të takimit, do të dilet me deklaratë për media.

Kryetari, me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:05.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj